

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**ME SELI NË PEQIN**

Sot, më datë 14.01.2019 (dymijë e nentembëdhjetë), ortaku themelues:

- **Z. Frederik Andreadou**, lindur në Topojan, më datë 26.03.1982, banues në Rr. Haxhi Hysen Dalliu, Tirane, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 033624925 dhe nr personal I20326231C, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

Vendosi themelimin e shoqërisë “**MAMAJ**” Sh.p.k., përmes ketij akt-themelimi

**NENI 1**

Shoqëria Tregtare “**MAMAJ**” Sh.p.k., themelohet në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me ligjin 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, (këtu e më poshtë **Shoqëria**).

Shoqëria është një person juridik Shqiptar.

**NENI 2**

**Emri dhe vula e shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin “**MAMAJ**” Sh.p.k  
Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

**NENI 3**

**Objekti i veprimtarisë**

Shoqeria ka per objekt veprimtarie:

- Transportin e mallrave te ndryshem mbrenda dhe jashte shtetit Shqiptar
- Tregtimin me shumice dhe pakice te produkteve industriale, te industrise minerare, hidroenergjitike, farmaceutike, te makinerive te ndryshme qe perdoren ne industri dhe ne transport e bujqesi.
- Ndertime server room
- Te bimeve dekorative dhe frutore, produkteve per bujqesine, vazove dhe aksesoreve, ushqimeve per kafshet, artikujve dhe mjeteve per kopshtari, makineri dhe pajisje perbuqjesi, konsulence, projektim, mirembajtie dhe realizim i kopshteve;
- Ndertime website
- Programime per amazon webservices
- Marrje, dhenie me qera apo perdonim i pasurive te paluajshme;
- Organizimin e panaireve, eveneteve dhe ekspozitave;
- Programime te ndryshme, sisteme kamerash, sistetme te avancuara software.
- Sherbime te avancuara IT.
- Import, eksport te lendeve djegese, gaz, nafte, benzine dhe nenproduktet e tyre.
- Studimin, projektimin, konsulencen, sipermarrjen zbatuese dhe /ose investimin, sipas rastit, per realizimin me fonde publike dhe /ose jo publike te veprave me karakter shfrytezin dhe /ose administrimi publike dhe /ose privat si ndertimin e ndertesave publike dhe private, rrugeve, urave, tuneleve, mbikalimet e nenkalimet, autostradave etj, si dhe cdo ndertim tjeter



sipas nenit 142 te Kodit Civil per shkak te trupezimit ne menyre te qendrueshme e te vazhdueshme me token ose ndertesen ku eshte vendosur.

- Tregetimin dhe import-eksport e mallrave te ndryshem si Industriale e artikujve te ndryshem ne per gjithesi e vecanerisht elementeve te ndryshme paisje elektrike, mekanike, elektronike, elektromekanike perfshire kondicioner, elektroshtepiake etj te ketij lloji. Bojrade te ndryshme me baze ujore dhe ne baze vajore per lyerje te fasadave te murit, te drurit, te hekurit etj, stuko patinimi koll, poliretaneve dh ete veglave te punes qe perdoren per lyerjen e tyre, materialve te ndertimit, etj.

Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë cdo lloj aktiviteti të parashikuar nga ligji në përputhje me rregullat e dispozitat në fuqi. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në bazë të autorizimeve dhe/ose lejeve përkatëse të lëshuara nga organet kompetente të fushës.

#### NENI 4

##### Selia e Shoqërisë

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën Fshati Bardhas, Njesia Administartive Gjocaj, Bashkia Peqin, Shqipëri.

#### NENI 5

##### Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributi në para i ortakut te vetem themelues. Kontributi në para do të ketë vlerën prej 100.000 (njeqind mijë) Lekë.

Ortaku themelues i Shoqërisë zotëron një kuotë në shoqëri si më poshtë:

- **Z.Frederik Andreadou** në cilësinë e ortakut te vetem themelues zotëron 100% të vlerës së kapitalit themeltar të Shoqërisë të barabartë me 1 kuotë ne vlerë prej 100.000 (njeqind mijë) Lekë.

Kapitali themeltar është derdhur në total nga ortaku themelues. Vlerësimi dhe pagesa e kapitalit themeltar është kryer nga ortaku me miratimin e këtij Akti.

#### NENI 6

##### Kohëzgjatja e shoqërisë

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit të shoqërisë është i pa përcaktuar.

#### NENI 7


##### Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asamblea e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartëvendimarrës;
2. Administratorët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Organizimi dhe funksionimi i këtyre organeve është përcaktuar në statutin e shoqërisë. Shoqëria administrohet nga Administratorët të cilët zgjidhen për një mandat pesëvjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

Administratori Shoqërisë do të jetë:



- **Z. Frederik Andreadou**, lindur në Topojan, më datë 26.03.1982, banues në Rr. Haxhi Hysen Dalliu, Tirane, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 033624925 dhe nr personal I20326231C, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratorët, të cilët i ushtrojnë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

#### NENI 8

Eksperti Kontabël i Autorizuar i shoqërisë do të emërohet në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi dhe për çdo vit financiar shoqëria do të emërojë një ekspertkontabël për të kontrolluar aktivitetin ekonomik të shoqërisë.

#### NENI 9

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, përpjesemarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo llojaktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

#### NENI 10

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

#### NENI 11

##### Legjislacioni i aplikuar

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga Statuti i firmosur nga ortakët themelues. Cdo gjë që nuk është parashikuar në Statut do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe nga dispozita ligjore në fuqi.

#### NENI 12

##### Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Mosmarrveshjet që mund të lindin gjate aktivitetit te shoqerise zgjidhen me konsensus, ne te kunder palet i drejtohen gjykates kompetente.

#### NENI 13

##### Dispozita Përfundimtare

Akti i themelimit përpilohet në tre kopje të njëjtë në gjuhën shqipe.

#### ORTAKU THEMELUES

**Shoqeria "MAMAJ" SH.P.K**  
Përfaqesuar nga

**FREDERIK ANDREADOU**

